Ernest Gjoka: Fitore e veshtire, por e merituar

nga AlbaniaSoccer
E diel, 27 Tetor 2013 17:46

Trajneri i Flamurtarit Ernest Gjoka ishte shume i kenaqur pas ndeshjes per fitoren e skuadres se tij, pasi ekipit vlonjat i duhej qe te permbyste disavantazhin. "Na duhej shume kjo fitore dhe me shume mund ja arritem. Ishte nje ndeshje shume e veshtire per ne,por dhe e bukur ku ne kthyem rezultatin ne avantazhin tone,pasi mbas nje gabimi te mbrojtjes tone u gjenden ne disavantazh. Shpresoj qe te vazhdojme me kete ritem,pasi ju e dini si na kane demtuar. Kukesi ka nje ekip shume cilesor me lojtare shume te mire, por sot shpirti i grupit i lojtareve tane triumfoi", theksoi Gjoka pas perfundimit te takimit.